

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29, paragrafi (2) të Ligjit për Mediat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.63/24, 74/24, 218/24 dhe 87/25), Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin e disponueshëm për përdoruesit nr.ark. 01-4443/1 datë 9.10.2018, pikat 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-1231/1 datë 19.3.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-1838/13 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËRON Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 14 të Ligjit për Media, në mënyrë që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor, të transmetuar më 3 mars 202, në dy edicione reprizë të programit t me fjalë-shou "Pastel" nuk i publikoi të dhënat që është i detyruar t'i transmetojë në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.10-1231/1 datë 19.3.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Median (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM-së.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë- paralajmërim publik në rastet kur është kryer shkelje cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga leja dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, masat që Agjencia, si organi rregullator kompetent, mund t'i ndërmarrë, dhe janë të përcaktuar në LShMAAV, përkatësisht zbatohen dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM-së.

Sipas nenit 14 të Ligjit për Median, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individual të përmbajtjes (për shembull, kopje të mediajs së shtypit, emision televiziv dhe në pjesën për impresium të medias online- internet portalit) të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme: emri dhe adresa e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i kryeredaktorit, pra redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emri dhe adresa e shtypshkronjës dhe data e shtypjes ose ribotimit, si dhe numri i kopjeve të shtypura, kur bëhet fjalë për media të shtypit. Për transmetuesit, detyrimi i mësipërm zbatohet në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizuale. Botuesi i medias është i detyruar në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të publikojë të dhënat e mëposhtme: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës(fragmentit) së publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, përkatësisht firmës që mban të drejtën autoriale për përmbajtjen e publikuar, përveç në mediat e shtypit dhe programet në radio, datën e produksionit (muaji dhe viti) kur bëhet fjalë për vepër audio/audiovizuale, origjinën e veprës audio/audiovizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacionin rreth saj, emrin e personit juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan pronën kulturore ose veprën arkivore të përdorur, përkatësisht riprodhimin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca programore ose fragmenti nga shtojca programore, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimit për impresium dhe informacionin e disponueshëm për përdoruesit, nr.ark.01-4443/1 datë 9.10.2018, për programe të tjera të prodhimit vendor, impresium publikohet në atë mënyrë që: në titrat e hapjes ose mbylljes publikohen të dhënat e mëposhtme: emri dhe mbiemri i kryeredaktorit të shërbimit programor; emri dhe mbiemri i kryeredaktorit të redaksisë nga ku buron programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/prezantuesit të emisionit; emri dhe mbiemri i bashkautorëve, përkatësisht i gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizuale; emri i subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesi, bashkëproducentët, producenti i pavarur të cilit i është porositur programi) dhe data e produksionit (muaji dhe viti). Nëse është e aplikueshme, duhet të publikohen të dhënat edhe për: emrin e personit juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan pronën kulturore të përdorur ose veprën arkivore, përkatësisht riprodhuesin e veprës, dhe emrin e subjekti tjetër nga i cili është marrë shtojcë e caktuar ose pjesë e shtojcës, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 19 mars 2026, kreu mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup, të transmetuar më 3 mars 2026, në nivel shtetëror, ku u konstatua shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media, në mënyrë që në pjesë të programeve të transmetuara më 3 mars 2026, nuk u publikuan të dhënat që identifikonin autorët që morën pjesë në përgatitjen e përmbajtjes audiovizuale, për bartësin e të drejtës autoriale, për redaktorin/redaktorët përgjegjës të programeve, redaktorin/redaktorët e programeve, për origjinën dhe datën e produksionit të veprave audiovizuale, emrin e mediumit nga i cili është marrë përmbajtja, etj., të cilat transmetuesi është i detyruar t'i transmetojë në vend të përshtatshëm për secilën përmbajtje të shërbimit programor. Konkretisht, mbikëqyrja konstatoi se transmetuesi, në kundërshtim me pikën 6 (impresium për programet e prodhimit vendor) të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion të disponueshëm për përdoruesit, pa impresium transmetoi dy edicione reprim të programit me fjalë-shou "Pastel".

Shkelja nga pikë 1 të këtij Aktvendimi, është specifikuar me datë, titull të emisionit, periudhë të transmetimit (fillim dhe mbarim) dhe përshkrim të shkeljes në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.10-1231/1 datë 19.3.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAA, Këshilli i Agjencia drejtuar ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup, më 24. 3.2026, dërgoi Shkresë nr.y në ark.10-1231/2 datë 24.3.2026, duke i dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.10-1231/1 datë 19.3.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune ditë nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencia të dorëzoj deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 25.3.2026. Në afatin e parashikuar, ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 27.4.2026 , shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe konkludoi që ShTR KOMPANI 21 -M ShPKNjP Shkup t'i shqiptoi masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenit 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin e disponueshëm për përdoruesit, pikat 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-1231/1 datë 19.3. 2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-1838/13 datë 27.4.2026, për konstatim të mosrespektimit të nenit 14 të LM-së, përcaktuar në pikën 1. të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup, dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LM-së. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.10-1231/1 datë 19.3.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
м-р Сашо Стефановски**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.